

## Listë verifikimi për zgjedhjen tënde të gjimnazit

Këtu i kemi zgjedhur disa pika që mund të jenë të rrëndësishme për të menduar parazgjedhjes tënde të gjimnazit. Mëso përfaktet! Parashtroni pyetje dhe krahasoni alternativat e ndryshme.

### Ti

Shëno se çka është me rëndësi për pikërisht ty dhe krahaso atë që ofrojnë shkollat. Ndoshta ke dëshirë të mësosh një gjuhë të veçantë? Të mundesh të mirresh me një sport të veçantë? Ose ndoshta të punosh sipas një mënyrë të posaçme të punës? Mos e shtyj anash zgjedhjen deri në sekkondën e fundit, por jepi vets kohë të mjaftueshme që të mësosh më tepër për alternativat e ndryshme.

## Përmbajtja e kualifikimit

Në rast se e zgjedh një kualifikim që vërtetë të intereson, mundësitë janë më të mëdha që t'ia dalësh mbanë. Lexo me kujdes përmbajtjen e kualifikimit dhe kujdesu që të shkollohesh për ato që të nevojiten në tregun e punës dhe për kualifikime të mëtutjeshme.

## Studime

Në rast se do të studiosh pas shkollës gjimnaziale, kontrollo se çfarë kompetence do të nevojitet dhe krahaso kurset që t'i ofron shkolla gjimnaziale. Informacione në lidhje me rregullat e pranimimit gjinden në Utbildningsinfo.se. Është jashtëzakonisht e rrëndësishme sidomos tani pasi që prej vitit 2010 vlejné rregulla të rreja për pranim për në universitet dhe fakultet.

Më tepër informacione në lidhje me rregullat e pranimimit:

<http://www.utbildningsinfo.se/sb/d/195/a/771>

## Punë

Ti që dëshiron të hyjsh shpejt në tregun e punës – lexo prognozatat tona për tregun e punës gjatë programit përkatës të gjimnazit. Aty shkruan se në çfarë mënyre do të jetë tregu i punës gjatë kohëve më të afërta dhe se në cilët sektorë kërkohet kualifikime më të gjata me qëllim për tu punësuar. Në rast se ke nevojë, mëso më tepër tek faqet e internetit të Zyrë së Punës Yrkeskompassen. Lexo poashtu edhe mbi intervistat që i kemi bërë me punëdhënësit.

Që nga viti 2008, një përpjekje për kualifikim zanati është në përbërje e sipër tek programet përgatitore për profesion. Pas këtyre, ti mund të jesh gati për tregun e punës pas pak më tërper se sa gjysma e kohës. Pyet në rast se shkolla e ofron këtë mundësi. Pyet poashtu edhe në rast se shkolla ofron më tepër mundësi për një kualifikim me vend pune (APU). Këtu ju mundësohen kontaktet dhe përvojat e rrëndësishme!

Bëhu ballëhapur dhe zgjidh interesimin tënd real.

Yrkeskompassen: <http://yrkeskompassen.arbetsformedlingen.se/>

## Zgjedhje personale

Çfarë mundësishë të ofron shkolla për zgjedhje mes kurseve të ndryshme? Bëshu i vetëdijshëm që hapsira për zgjedhje personale mund të ndryshojë mes kualifikimeve të ndryshme. Një program i formuar posaqërisht ose një kualifikim te një shkollë e veçuar nuk do të thotë së ofron kurse me

mundësi zgjedhjeje të njejta si ato të programeve kombëtare në një shkollë komunanle. Kjo nuk do të thotë se është diçka negative, por është me rëndësi që t'ë diësh këto gjëra paraprakisht. Mëso se çka është e fshehur pas asaj degës “moderne” që e ofron shkolla. Sa kurse dhe sa poena do të marrësh në të vërtetë? Dhe çka është ajo që e ke lënë anash?

Në rast se ndejhesh i pasigurt mund të jetë mirë që të puyesësh në rast se ke ndonjë mundësi që të i shtysh zgjedhje e tua. Zgjidh një program dhe një shkollë ku do të nevojitet që zgjedhësh degën dhe thellimin pas vitit të dytë dhe të tretë. Atëherë do të kesh mundësi që të mendosh pak në fillim.

## **Gjuhë**

Cilat gjuhë i ofron shkolla? Gjuhët janë një kompetencë e vlefshme të cilat mund t'i përdorësh gjatë tërë jetës. Vë re që kurset e larta në anglisht dhe gjuhët moderne që nga viti 2010 do të japin poena suplementare kur do të kërkosh pranim në fakultet.

Mbaroje shkollimin!

Hulumtimeet tregojnë se ata që kanë pikënisjen më të keqe të mudshme te tregu i punë janë ata që i kanë ndërprerë shkollimet gjimnaziale dhe që nuk e kanë mabruar shkollimin. Edhe në rast se ndonjëherë është vështirë – mundohu t'i kompletosh studimet e tua dhe të marrësh notën përfundimtare. Kujdesu që të të ndihmojnë të shkolla nëse je ngatërruar me ndonjë apo disa lëndë. Kontakto me këshilltarin tënd, udhërrëfyesin e studimeve dhe të profesioneve, një mësues që i beson ose me punonjësin social.